REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:095495

Datë: 05.07.2022

Numri i dokumentit: 03200567

C.nr.344/2020

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Robert Tunaj , dhe procesmbajtës F.Kabashi në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit, KEDS SHA me seli në Prishtinë kundër të paditurit, I. F. me numër personal ....., me vendbanim në S. për kompenzim dëmi me datë 05.07.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

APROVOHET si tërësisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit/es KEDS Sh.A nga Prishtina

DETYROHET i padituri I. F. që paditëses në emër të kompensimit të demit material t'ia paguajë shumëm prej 169.26€ me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, se dhe në emër të shpenzimeve të procedurës për tasat gjyqësore shumën 20€.

A r s y e t i m

Paditësi, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet i padituri që në emër të kompensimit të dëmit paditësit t'ia paguajë shumën prej 169.26 eurosh. Ka shtuar se përgjegjësia e të paditurit për shkaktimin e dëmit është provuar me Aktgjykimin Penal P.nr.350/19 të datës 25.06.2020 të Gjykatës Themelore të Prizren Dega në Suharekë.
Ndërsa lartësia e kërkesëpadisë është provuar në bazë të faturës për rikthim të humbjeve DPZHP..... të datës 28.08.2019. Ka kërkuar edhe kamatën ligjore dhe shpenzimee e procedurës .

I padituri me parashtresën e datës 02.02.2022 për përgjegjen në padi ka pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurës, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se "*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e*

2020:095496

shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejmë, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)" – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën u morë konform nenit 382 të LMD-së

Vendimi për shpenzimet e procedurës e mori konform nenit 452 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:095496, 05.07.2022

G j y q t a r i

_____
Robert Tunaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.